

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 64, datë 30.3.2021

PËR NGRITJEN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT SEKTORIAL TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 10 247, datë 4.3.2010, “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, të ndryshuar, të vendimit nr. 426, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit, të funksionimit, si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteteve sektoriale dhe mënyrën e shpërblimit të tyre”, ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional dhe ministri përgjegjës për arsimin

URDHËROJNË:

1. Ngritjen e Komitetit Sektorial të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).
2. Komiteti Sektorial TIK, organizohet në formën e grupit teknik dhe ka në përbërje 10 (dhjetë) anëtarë, si më poshtë:
 - a) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;
 - b) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional;
 - c) një përfaqësues nga ministria/institucioni përgjegjës për sektorin e TIK-ut;
 - ç) një përfaqësues nga shoqatat e punëdhënësve të sektorit të TIK-ut, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;
 - d) një përfaqësues nga shoqatat e punëmarrësve që mbulojnë sektorin TIK, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;
 - dh) një përfaqësues nga institucionet ofruese të arsimit dhe të formimit profesional (AFP) të sektorit TIK, me numrin më të madh të nxënësve/kursantëve në sektorin përkatës;
 - e) një përfaqësues të biznesit me praktika të pasura në zhvillimin e burimeve njerëzore në sektorin TIK;
 - ë) tre ekspertë të pavarur, me përvojë jo më pak se 5 (pesë) vjet në zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).
3. Kryetari zgjidhet në mbledhjen e parë të komitetit dhe, si rregull, duhet të jetë anëtar i me shumë eksperiencë në çështjet e TIK-ut dhe në zhvillimin e zbatimit të KSHK-së.
4. Ngarkohen ministratë përgjegjëse respektive për caktimin e anëtarëve të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “dh”, të pikës 2, të këtij urdhri, në bazë të kriterëve të parashikuara në vendimin nr. 426, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, dhe përcjelljen e tyre Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), jo më vonë se 1 (një) muaj nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
5. Ngarkohet AKAFPK-ja për përzgjedhjen e anëtarëve të parashikuar në shkronjat “ç”, “d”, “e” dhe “ë”, të pikës 2 të këtij urdhri, si dhe titullari i saj për ngritjen e sekretariatit teknik, brenda 1 (një) muaj nga hyrja e tij në fuqi.
6. Ngarkohen ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, ministria përgjegjëse për arsimin, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe Komiteti Sektorial i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Anila Denaj

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Evis Kushi

